

1 E hënë, 28 shtator 2020

2 [Paraqitja e parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: Mirëdita dhe mirë se erdhët të gjithë  
7 brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Përpara se të fillojmë, në bazë të vendimit për caktimin  
9 e datës së paraqitjes së parë, do t'i kërkoj fotografit të  
10 gjykatës që të bëjë fotografi për një minutë e gjysmë.

11 Urdhëroni zoti fotograf.

12 Ju faleminderit. Tani mund të largoheni nga salla e  
13 gjyqit.

14 Zonja sekretare e çështjes, a mund ju lutem të vijoni me  
15 paraqitjen e lëndës?

16 SEKRETARJA E ÇËSHTJES GJYQËSORE: Faleminderit i nderuar  
17 gjykatës. Lënda KSC-BC-02-05, Prokurori i Specializuar kundër  
18 Salih Mustafës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja Sekretare e  
20 Çështjes.

21 Përpara se t'iu kërkoj të pranishmëve në sallë të  
22 prezantohen, dua t'jua rikujtoj të gjithëve disa rregulla që  
23 duhet të respektohen gjatë gjithë kohës për ecurinë normale të  
24 seancës.

25 Prandaj ju lutem, siguroni që ta ndizni mikrofonin

1 përpara se të flisni dhe ta fikni kur të keni përfunduar.  
2 Flisni ngadalë dhe qartë, duke qenë se ajo që thuhet  
3 përkthehet në shqip dhe anglisht -- serbisht dhe prej këtyre  
4 gjuhëve. Pritni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua,  
5 ose palëve apo pjesëmarrësve, në mënyrë që t'iu mundësojmë  
6 përkthyesve të përfundojnë me përkthimin.

7 Ajo që thuhet në këtë seancë gjyqësore transkriptonet në  
8 kohë reale, dhe do të reflektohet në transkriptim i cili do  
9 t'iu vihet në dispozicion palëve dhe publikut pas kësaj seance.

10 Dua gjithashtu t'iu rikujtoj palëve se një pjesë e  
11 informacionit në këtë çështje është objekt i masave mbrojtëse  
12 dhe urdhrave të konfidencialitetit. Këtu përfshihet  
13 informacion konfidencial që është redaktuar nga Aktakuza e  
14 Konfirmuar në lidhje me identitetin e disa individëve, data,  
15 vendndodhje dhe informacione të tjera.

16 Informacioni konfidencial nuk nxirret në seancë të hapur.  
17 Në qoftë se një palë, ose pjesëmarrës nën procedurë, do të  
18 kalojë në seancë private për t'iu referuar ndonjë informacioni  
19 konfidencial, atëherë ju lutem që këtë ta përmendni dhe të  
20 paraqitni arsyet.

21 Tani do të kërkoj nga palët dhe pjesëmarrësit që të  
22 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të  
23 Specializuar.

24 Z. WHITING: Mirëdita i nderuar gjykatës. Për  
25 Prokurorinë, Prokurori i Specializuar z. Jack Smith; znj.

1 Silvia D'ascoli, ndihmësprokurore; znj. Line Pedersen,  
2 administratore e çështjes; znj. Aniko Boldog, ndihmëse; dhe  
3 unë jam Alex Whiting, Zëvendëskryeprokuror.

4 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zoti Zëvendësprokuror.  
5 Tani i drejtohem mbrojtjes.

6 Z. VON BONE: Mirëdita. Unë jam Julius von Bone, avokat  
7 mbrojtës i z. Salih Mustafa. Ky jam unë. Jam anëtar i Shoqatës  
8 së Avokatëve të Roterdamit.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit. Z. Mustafa, klienti  
10 juaj, është i pranishëm në sallën e gjyqit. Këtë e them për  
11 hir të procesverbalit.

12 Tani Zyra Administrative.

13 ADMINISTRATORJA: Mirëdita. Unë jam Fidelma Donlon,  
14 Administratorja.

15 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja Administratore.

16 Dhe për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, gjykatës  
17 i procedurës paraprake në këtë çështje.

18 I akuzuari paraqitet për herë të parë pas konfirmimit të  
19 një Aktakuze kundër tij.

20 Z. Mustafa, ngrihuni në këmbë ju lutem.

21 A mund të na e thoni emrin dhe mbiemrin ju lutem?

22 I AKUZUARI: Përshëndetje për të gjithë. Unë jam Salih  
23 Mustafa, i lindur më 01/01/1972 në Prishtinë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: Shtetësia dhe profesioni juaj aktual?

25 I AKUZUARI: Gjuha jeme amtare është gjuha shqipe, ndërsa

1 unë jam qytetar, ose shtetas i Republikës së Kosovës.

2 GJYKATËSI GUILLOU: Dhe çfarë profesioni keni? Cili është  
3 profesioni juaj?

4 I AKUZUARI: Profesioni im, në aspektin shkollor jam  
5 ekonomist, ndërsa jam zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes të  
6 Republikës së Kosovës.

7 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit. Mund të uleni.

8 Tani do të kaloj në historikun procedural të çështjes.

9 Më 12 qershor 2020, si gjykatës i procedurës paraprake,  
10 konfirmova Aktakuzën e paraqitur nga Prokurori i Specializuar  
11 kundër këtij të akuzuari, ku akuzohet për krimet e luftës si  
12 në vijim: Pika një, ndalim arbitrar; Pika 2, trajtim mizor;  
13 Pika 3, torturë; dhe Pika 4, vrasje.

14 I akuzuari u arrestua në Kosovë më 24 shtator 2020, dhe  
15 në atë moment atij iu dorëzua Aktakuza e konfirmuar. Ai u  
16 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të  
17 Specializuara të Kosovës në Hagë po atë ditë.

18 Z. Mustafa, përpara se të vazhdojmë dua të sigurohem se  
19 mund t'i ndiqni këto procedura në një gjuhë që e kuptoni dhe e  
20 flisni. A mund ju lutem të konfirmoni se e flisni dhe e  
21 kuptoni shqipen?

22 I AKUZUARI: Po, i nderuar gjykatës.

23 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Mustafa.

24 Me këtë konfirmoj që mund t'i ndiqni procedurat në  
25 shqipe, një gjuhë që e kuptoni dhe e flisni në përputhje me

1 rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

2 Në qoftë se në çfarëdo momenti gjatë procedurës së sotme,  
3 apo gjatë ndonjë seance dëgjimore tjetër, nuk dëgjoni  
4 përkthimin, ju lutem të më informoni menjëherë, në mënyrë që  
5 kjo të rregullohet.

6 Tani më lejoni që t'jua shpjegoj qëllimin e paraqitjes së  
7 parë për nevoja të të akuzuarit, por gjithashtu edhe për ata  
8 që janë në galeri, për publikun dhe ata që ndjekin seancën  
9 online.

10 Seanca e sotme nuk është gjykim. Në të nuk do të  
11 paraqiten prova dhe nuk do të debatohen prova. Fajësia apo  
12 pafajësia e të akuzuarit nuk do të diskutohet dhe nuk do të  
13 përcaktohet.

14 Qëllimi i paraqitjes së parë, rregullohet me rregullën 39  
15 të Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores. Sipas këtyre  
16 dispozitave, unë si gjykatës i procedurës paraprake duhet:

17 T'ia lexoj akuzat e përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar  
18 të akuzuarit në një gjuhë që ai e kupton dhe e flet;

19 Të bindem se i akuzuari i kupton akuzat në Aktakuzë;

20 Të bindem se të drejtat e të akuzuarit, veçanërisht e  
21 drejta e tij për avokat mbrojtës, janë respektuar;

22 Ta informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita e  
23 sotme, atij do t'i kërkohet të deklarojë nëse është fajtor ose  
24 i pafajshëm për çdo akuzë të paraqitur në Aktakuzë. Në qoftë  
25 se dëshiron, i akuzuari mund të deklarojë menjëherë nëse është

1 fajtor, ose i pafajshëm;

2 Dhe së fundi, duhet të caktoj datat e tjera sipas rastit  
3 për kryerjet e funksioneve të mia si gjykatës i procedurës  
4 paraprake.

5 Tani kërkoj prej palëve që t'i respektojnë këto çështje.  
6 Në qoftë se ndonjë prej palëve dëshiron të diskutojë ndonjë  
7 çështje që nuk është parashikuar në kontekst të kësaj seance  
8 të paraqitjes së parë, atëherë i ftoj palët që këtë ta bëjnë  
9 me shkrim, duke më paraqitur me shkrim parashtrime.

10 Z. Mustafa, a mund të ma konfirmoni që keni marrë  
11 Aktakuzën e konfirmuar të datës 19 qershor 2020 në një gjuhë  
12 që ju e kuptoni dhe flisni?

13 I AKUZUARI: Po. E kam pranuar edhe e kuptoj.

14 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit z. Mustafa.

15 Tani do t'i kërkoj sekretares së çështjes që t'i lexojë  
16 akuzat në përputhje me rregullën 92 të Rregullores dhe nenin  
17 39 të Ligjit.

18 SEKRETARJA E ÇËSHTJES GJYQËSORE: Faleminderit i nderuar  
19 gjykatës.

20 Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurori i Specializuar  
21 akuzon z. Salih Mustafa me:

22 Pika 1: Krimin e luftës të ndalimit arbitrar, në bazë të  
23 nenit 14(1)(c) të Ligjit, i kryer në një kompleks ndalimi në  
24 Zllash, Kosovë, kundër të paktën gjashtë individëve midis  
25 afërsisht 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999;

1 Pika 2: Krimin e luftës të trajtimit mizor, në bazë të  
2 nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, i kryer në një kompleks ndalimi  
3 në Zllash në Kosovë, kundër të paktën gjashtë individëve midis  
4 afërsisht 1 prill 1999 dhe 19 prillit 1999;

5 Pika 3: Krimin e luftës të torturës, në bazë të nenit  
6 14(1)(c)(i), i kryer në një kompleks ndalimi në Zllash në Kosovë,  
7 kundër të paktën gjashtë individëve midis afërsisht 1 prillit  
8 1999 dhe 19 prillit 1999;

9 Dhe Pika 4: Krimin e luftës të vrasjes së paligjshme, në  
10 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, i kryer në një kompleks  
11 ndalimi në Zllash në Kosovë, kundër një individi midis  
12 afërsisht 19 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999.

13 Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë se  
14 z. Mustafa është penalisht përgjegjës në bazë të nenit  
15 16(1)(a) të Ligjit për:

16 Kryerje fizike të krimeve të përfshira në pikat 1 deri në  
17 3;

18 Kryerjen si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët  
19 të krimeve në pikat 1 deri në 4; dhe në alternativë për pikën  
20 4, për kryerjen si anëtar i ndërmarrjes kriminale të  
21 përbashkët të përmendur më lartë, e krimit të vrasjes së  
22 paligjshme, duke qenë i vetëdijsëm se një krim i tillë mund  
23 të kryhej gjatë zbatimit të qëllimit të përbashkët të  
24 ndërmarrjes kriminale të përbashkët, dhe duke marrë përsipër  
25 këtë rrezik me vullnet të lirë;

1 Urdhërimin e krimeve në pikat 1 deri në 3;

2 Nxitjen e krimeve në pikat 1 deri në 3; dhe

3 Më tej dhe në alternativë, ndihmën dhe inkurajimin e  
4 krimeve në pikat 1 deri në 4.

5 Gjithashtu dhe në alternativë ndaj përgjegjësisë së  
6 pretenduar, në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston një  
7 dyshim i bazuar mirë, se z. Mustafa është penalisht përgjegjës  
8 për krimet në pikat 1 deri 4 si epror në bazë të nenit  
9 16(1)(c) të Ligjit.

10 Ju faleminderit i nderuar gjykatës.

11 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit sekretarja e gjykatës.

12 Z. Mustafa, ju kujtoj që kjo nuk është koha për të  
13 kundërshtuar akuzat, por thjesht për të pranuar se i kuptoni  
14 akuzat. Do të keni mundësi të bollshme që t'i kundërshtoni  
15 akuzat me ndihmën e avokatit tuaj mbrojtës.

16 Z. Mustafa, a mund të çoheni në këmbë ju lutem.

17 A i kuptuat akuzat që janë të përfshira në Aktakuzën e  
18 Konfirmuar, siç e lexoi sekretarja e çështjes gjyqësore?

19 I AKUZUARI: Po i kuptova.

20 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Mustafa. Mund të  
21 uleni.

22 Tani do t'ju informoj për të drejtat tuaja në këtë  
23 gjykatë.

24 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e  
25 Procedurës dhe Provave ju garantojnë një numër të drejtash.



1 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm derisa të vërtetohet  
2 fajësia juaq përtej dyshimit të arsyeshëm.

3 Në përcaktimin e akuzave kundër jush, ju keni të drejtën  
4 e një seance dëgjimore të drejtë dhe publike në varësi të  
5 masave që urdhërohen për mbrojtjen e viktimave dhe  
6 dëshmitarëve.

7 Keni të drejtën të informoheni menjëherë dhe në hollësi  
8 në një gjuhë që e kuptoni, për arsyet dhe natyrën e akuzave  
9 kundër jush.

10 Ju keni të drejtë të keni kohë të mjaftueshme dhe  
11 lehtësitë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes tuaj, dhe  
12 të komunikoni me mbrojtësin që e zgjidhni vetë.

13 Ju keni të drejtën të gjykoheni brenda një kohë të  
14 arsyeshme.

15 Ju keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj dhe të  
16 mbroheni përmes avokatit tuaj mbrojtës.

17 Keni të drejtën e mbrojtësit. Që t'ju caktohet mbrojtësi  
18 dhe pa pagesë, në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme  
19 financiare për ta paguar atë.

20 Keni të drejtën t'i bëni pyetje dëshmitarëve kundër jush,  
21 ose dikush tjetër t'i bëjë pyetjet në emrin tuaj, dhe të  
22 kërkoni paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në  
23 emrin tuaj.

24 Keni të drejtën e ndihmës pa pagesë të një përkthyesi, në  
25 qoftë se nuk e kuptoni apo flisni gjuhën që flitet në gjykatë.

1 Keni të drejtën të mos ju detyrojnë të dëshmoni kundër  
2 vetes tuaj, apo të pranoni fajësinë.

3 Keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe nga kjo heshtje  
4 e juaj nuk do të nxirret asnjë përfundim negativ.

5 Po kështu keni të drejtë të bëni deklaratata pa betim që  
6 lidhen me çështjen dhe mund të paraqiteni edhe si dëshmitar  
7 nën betim.

8 Keni të drejtën që të paraqisni mocione paraprake për të  
9 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, të  
10 pretendoni defekte apo të meta në formën e Aktakuzës dhe të  
11 kërkoni veçimin e akuzave në Aktakuzë.

12 Keni të drejtën që brenda 30 ditësh nga data e sotme të  
13 merrni materialet mbështetëse të Aktakuzës që është dorëzuar  
14 për konfirmim.

15 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e  
16 dëshmitarëve të cilët Prokurori i Specializuar ka ndërmend t'i  
17 thërrasë për të dhënë dëshmi, në një gjuhë që ju e kuptoni dhe  
18 e flisni; pra, në shqip.

19 Keni të drejtën që të merrni menjëherë çfarëdo  
20 informacioni që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme  
21 pafajësinë tuaj, apo të zbus fajësinë tuaj, ose që mund të  
22 ndikojë te besueshmëria e provave të Prokurorit të  
23 Specializuar, sapo ky informacion të jetë në mbajtjen,  
24 kontrollin, ose dijeninë e Prokurorit të Specializuar.

25 Keni të drejtën që të gjitha materialet dhe provat

1 relevante, apo faktet relevante që ka Prokuroria, t'ju jepen  
2 përpara fillimit dhe gjatë procedurave.

3 Kjo e drejtë është vetëm në varësi të kufizimeve të cilat  
4 janë rreptësisht të domosdoshme dhe kur ka nevojë për masa  
5 mbrojtëse balancuese.

6 Ju keni të drejtën që të mos mbaheni në paraburgim për  
7 një kohë të paarsyeshme përpara hapjes së çështjen. Të kërkonte  
8 shqyrtimin, rishqyrtimin e vendimit për parandalimin tuaj, dhe  
9 të bëni apel kundër këtyre vendimeve drejtpërsëdrejti para  
10 Gjykatës së Apelit.

11 Keni të drejtën që të paraqiteni drejtpërsëdrejti para  
12 Gjykatës së Apelit dhe ta apelsoni vendimin për mocionet  
13 paraprahe që kundërshtojnë juridiksionin e Dhomave të  
14 Specializuara.

15 Po kështu keni të drejtën të kërkonte leje të bëni apel  
16 kundër vendimeve të tjera.

17 Z. Mustafa, ju i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme të  
18 cilat i gëzoni në përputhje me kornizën ligjore përkatëse të  
19 Dhomave të Specializuara.

20 A i kuptoni këto të drejta z. Mustafa?

21 I AKUZUARI: Po, i kuptoj zoti gjykatës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Mustafa.

23 Dua t'ju informoj se sipas nenit 21(5) të Ligjit, ju nuk  
24 mund të përfaqësoni vetveten, sepse tani jeni në paraburgim.

25 Për këtë arsye është e detyrueshme përfaqësimi nga mbrojtësi i

1 specializuar.

2       Është detyra ime, si gjykatës i procedurës paraprake, që  
3 të siguroj që e drejta për të pasur mbrojtës të respektohet.

4 Për këtë qëllim e kam parë dhe e kam pranuar materialin e  
5 Administratores, që më informon për panelin për caktimin e  
6 avokatit mbrojtës.

7       Unë, nga raporti i Administratores dhe nga avokati juaj,  
8 kuptoj që ju jeni përfaqësuar jo vetëm për qëllimet e kësaj  
9 paraqitjeje të parë, por edhe që ju është caktuar një mbrojtës  
10 për të gjithë kohëzgjatjen e procedurave në përputhje me  
11 seksionin 13 -- 14 të direktivës për avokatët mbrojtës.

12       Z. Mustafa, a mund të konfirmoni që z. von Bone ju është  
13 caktuar për të gjithë procedurën, të gjithë kohëzgjatjen e  
14 procedurës?

15       I AKUZUARI: Po zoti gjykatës, e konfirmoj.

16       GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Mustafa.

17       Atëherë, nga kjo rrjedh që i akuzuari përfaqësohet nga  
18 mbrojtësi.

19       Tani do t'i jap mundësi të akuzuarit që të ketë mundësinë  
20 të vetëdeklarohet në lidhje me akuzat, në qoftë se ka, në  
21 përputhje me rregullën 92.

22       Z. Mustafa, brenda 30 ditësh nga dita e sotme, ju do të  
23 thirreni që të pranoni fajësinë, ose të vetëdeklaroheni  
24 jofajtor, për secilën prej akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar.  
25 Në qoftë se dëshironi, ju mund të zgjidhni menjëherë tani të

1 pranoni fajësinë, ose të deklaroheni jofajtor, i pafajshëm.

2 Pra, do t'ju ftoja z. Mustafa, ose do t'ju pyes që, a  
3 keni pasur mundësinë që t'i diskutoni akuzat me avokatin tuaj,  
4 dhe në qoftë se jeni i përgatitur sot që të vetëdeklaroheni  
5 për akuzat?

6 Ju lutem çohuni në këmbë në qoftë se doni të  
7 vetëdeklaroheni sot.

8 I AKUZUARI: [Heshtje]

9 GJYKATËSI GUILLOU: Mikrofondi nuk ishte i ndezur, kështu  
10 që ju lutem, a mund ta përsërisni përgjigjen tuaj?

11 I AKUZUARI: Të më fal zoti gjykatës që nuk do të  
12 deklaron sot. Do të konsultona me avokatin.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit. Mund të uleni.

14 Duke pasur parasysh që z. Mustafa nuk është vetëdeklaruar  
15 sot, dua që palët ju lutem të paraqesin mendimet e tyre  
16 paraprake, në qoftë se kanë, në lidhje me kalendarin apo  
17 orarin e seancave të tjera për vetedeklarimin, duke filluar me  
18 mbrojtjen.

19 Z. von Bone.

20 Z. VON BONE: Faleminderit i nderuar gjykatës. Kam vetëm  
21 nja dy çështje praktike që desha të përmend në këtë moment.

22 Do të ishte shumë e dobishme në qoftë se z. Mustafa do  
23 t'i jepej një kopje në letër e të gjithë dokumenteve ligjore  
24 të Dhomave të Specializuara të Kosovës në gjuhën e tij.

25 Dhe siç e përmendët i nderuar gjykatës, mbrojtja në këtë

1 moment nuk e përjashton mundësinë e dorëzimit të mocioneve të  
2 cilat kundërshtojnë juridiksionin apo legalitetin,  
3 ligjshmërinë e gjykatës. Dhe fakti që jemi këtu sot, nuk do të  
4 thotë që mbrojtja e pranon gjykatën si të tillë. Po këtë do ta  
5 bëjmë me kalimin e kohës përmes mocioneve tona.

6 Për sa i përket afateve kohore, jua lë në dorë ju i  
7 nderuar gjykatës për të parë se çfarë është më e përshtatshme  
8 për të gjitha palët. Sigurisht unë do ta vë veten time në  
9 dispozicionin tuaj, edhe klienti im po ashtu. Dhe do të  
10 sigurojmë që të dy ne do të jemi të pranishëm në kohën kur do  
11 të na kërkohet. Dhe shpresoj që Prokuroria dhe dokumentet e  
12 Prokurorisë që do t'i dorëzohen klientit tim, do t'i jepen  
13 klientit tim, sepse do të ishte nga ana praktike shumë më  
14 kollaj të punohet me klientin tim në qoftë se kjo bëhet në  
15 mënyrën e duhur.

16 Pra, për momentin kjo është e kufizuar në kopjet në letër  
17 të teksteve bazë ligjore. Megjithatë, me kalimin e kohës  
18 Prokuroria do të japë, do të bëjë të ditura edhe provat që ka  
19 kundër klientit tim. Dhe shpresoj dhe besoj që kjo do të jetë  
20 në një gjuhë që ai e kupton; pra, shqipja.

21 Këto janë vërejtjet e mija paraprake i nderuar gjykatës.  
22 Nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar në këtë moment.

23 Të konsultohem me klientin tim.

24 [Avokati mbrojtës konsultohet me të akuzuarin]

25 Z. VON BONE: Nga pala jonë për momentin kaq kemi.

1 Faleminderit.

2 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit i nderuar mbrojtës.

3 Përpara se t'ia jap fjalën Prokurorit, desha të them që  
4 sigurisht është prioritet që z. Mustafa t'i jepen kopje në  
5 letër të dokumenteve ligjore në një gjuhë që ai e kupton. Dhe  
6 do t'i kërkoj Administratores që kjo të bëhet sa më shpejt që  
7 të jetë e mundur.

8 Z. Prokuror keni fjalën.

9 Z. WHITING: Faleminderit i nderuar gjykatës.

10 Për sa i përket materialeve që do t'i bëhen të ditura  
11 palës tjetër. Unë do të filloj... Ne do ta bëjmë dhënien e  
12 këtyre materialeve sipas rregullave, sapo mbrojtësi të lidhet  
13 me sistemin elektronik Legal Workflow, që besoj që do të bëhet  
14 sot dhe nesër. Dhe ne do t'i bëjmë të ditura të gjitha  
15 dokumentet dhe do t'i përmbahemi rregullave në mënyrën e  
16 duhur.

17 Për sa i përket orareve dhe ditëve kur do të zhvillohet  
18 seancat e tjera, ne do t'i përmbahemi asaj që do të thotë  
19 gjykata.

20 GJYKATËSI GUILLOU: Atëherë, seanca për vetëdeklarim do  
21 të caktohet më vonë.

22 Në këtë moment desha t'i pyes palët nëse kanë çështje të  
23 tjera për të ngritur. Dhe dua t'ju kujtoj, se për çdo  
24 informacion që është konfidencial, duhet të më thonë  
25 paraprakisht, në mënyrë që të merren masat e duhura.

1 Z. VON BONE: Mbrojtja. Besoj, i nderuar gjykatës, që në  
2 këtë do të përfshihet një Aktakuzë më e saktë, sepse klienti  
3 im ka marrë vetëm versionin e redaktuar të Aktakuzës. Nuk e di  
4 në këtë moment, nëse këto janë redaktuar për shkak të masave  
5 mbrojtëse, apo kush është përmendur në versionin e redaktuar.  
6 Megjithatë, kur të jetë e disponueshme Aktakuza e plotë, na  
7 duhet.

8 Dhe sigurisht të gjitha këto gjëra janë shumë të reja për  
9 klientin tim. Ai menjëherë ka ardhur papritur në një vend të  
10 huaj, me shumë njerëz që nuk i njeh. E kanë marrë, e kanë  
11 arrestuar, e kanë transferuar këtu dhe i kanë dhënë disa  
12 dokumente në duar. Kështu që do t'i duhet njëfarë kohe për t'u  
13 përshtatur dhe për të parë se çfarë është e përshtatshme për  
14 të bërë në lidhje me kundërshtimin e Aktakuzës si e tërë.

15 Sigurisht kjo gjykatë ka një format unik në spektrin  
16 ndërkombëtar. Është një gjykatë kombëtare që zbaton rregulla  
17 dhe rregullore ndërkombëtare, dhe në qoftë se do të ketë  
18 mospërputhje midis këtyre rregullave ndërkombëtare dhe  
19 rregullave kombëtare që mund të jenë në mospërputhje me njëra-  
20 tjetrën, unë kërkoj që të ruhen interesat dhe të mbrohen  
21 interesat e klientit tim, dhe të sigurohet që i akuzuari të  
22 ketë përfitimin e tyre.

23 Kaq kisha për të thënë për momentin. Nuk kam më gjë për  
24 të shtuar.

25 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit i nderuar mbrojtës.



1 Z. WHITING: Faleminderit i nderuar gjyqtar. Nuk ka asgjë  
2 më tepër nga Prokuroria.

3 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Mustafa, tani do të doja t'ju  
4 kërkoja dhe na thoni ju lutem, në qoftë se keni ndonjë çështje  
5 apo komente të cilat ju do të dëshironi që t'i ngrini para  
6 nesh, lidhur me arrestimin, me transferimin apo me ndalimin  
7 tuaj.

8 I AKUZUARI: Jo, nuk kam ndonjë çështje për ta theksu.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Mustafa.

10 Së fundi, do të doja t'ju informoja që sapo kanë nxjerrë  
11 disa vendime me pikëpamjen për të pasur proces të rregullt.  
12 P.sh., një prej tyre ka të bëjë me një vendim që urdhëron  
13 Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Administratoren, për të  
14 riklasifikuar dosjet e tyre, apo për të përgatitur versionet e  
15 redaktuara, në mënyrë që mbrojtja të ketë akses në to sa më  
16 shpejt të jetë e mundur;

17 Një vendim që kërkon konstatime nga palët për regjimin,  
18 apo për mënyrën e konstatimit të redaktimeve për çështjen në  
19 fjalë;

20 Dhe një vendim që kërkon konstatime nga palët, për gjuhën  
21 e punës që do të përdoret për çështjen në fjalë.

22 Do të doja të informoja po ashtu, që do të planifikoj një  
23 konferencë për ecurinë e çështjes në përputhje me rregullën  
24 96. Dhe qëllimi kryesor i kësaj seance do të jetë që të  
25 rishikohet statusi apo gjendja e çështjes, dhe të organizohen

1 shkëmbime ndërmjet palëve, për të siguruar përgatitje të  
2 shpejta për procesin e gjykimit.

3 Z. Mustafa, dëshiroj t'ju kujtoj, që ju keni të drejtë që  
4 të merrni pjesë në këtë konferencë për ecurinë e çështjes  
5 gjyqësore kundër jush së bashku me mbrojtjen tuaj. Megjithatë,  
6 me pëlqimin me shkrim nga ju, dhe pas marrjes së këshillave  
7 përkatëse nga mbrojtja, në përputhje me rregullën 96(2),  
8 konferenca për ecurinë e çështjes mund të realizohet në  
9 praninë tuaj personalisht me mbrojtjen tuaj, që merr pjesë  
10 përmes videokonferencës nga mbrojtësi juaj me juve z. Mustafa,  
11 që mund të merrni pjesë përmes videokonferencës. Dhe mund të  
12 realizohet gjithashtu edhe në mungesën tuaj z. Mustafa, me  
13 praninë e këshilltarit tuaj ligjor, ose nëpërmjet  
14 videokonferencës, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë.

15 Do të doja që t'ju tërhiqja vëmendjen palëve që në qoftë  
16 se është e mundur, kjo konferencë për ecurinë e çështjes mund  
17 të realizohet ose deri në fund të kësaj jave, ose jo më vonë  
18 sesa fillimi i javës që vjen.

19 Z. WHITING: Për neve nuk ka problem i nderuar zoti  
20 gjyqtar. Mund të jetë ose në fund të kësaj jave, ose në fillim  
21 të javës tjetër.

22 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit shumë.

23 Z. VON BONE: Ju faleminderit. Ju kërkoi ndjesë, nuk e  
24 kam agjendën me vete. Por unë mendoj që në qoftë se do të  
25 planifikohet për fillimin e javës tjetër, do të ishte më mirë.

1 Faleminderit.

2 GJYKATËSI GUILLOU: Pra, do të marrim rregullin për  
3 programin shumë shpejt, mbase në fillim të fillim të javës  
4 tjetër, dhe do t'ju japim agjendën përkatëse brenda afateve  
5 kohore të pranueshme.

6 Dhe pas kësaj konference për ecurinë e çështjes, unë do  
7 të vendos, do të marr një vendim për sa i takon detyrimeve për  
8 bërjen publike të informacionit nga Prokurori i Posaçëm në  
9 përputhje me rregullën 102.

10 Do t'i ftoja palët që të bënin depozitimet e tyre me  
11 shkrim deri të premtën e kësaj jave, sa i takon çështjes së  
12 përmendur më sipër.

13 Z. Mustafa, përderisa ju vazhdoni që të jeni i ndaluar,  
14 do të doja që t'ju informoja që mund të kundërshtoni ndalimin  
15 tuaj në përputhje me rregullin 57. Kjo do të bëhet në  
16 përputhje me rregullat, me procedurat me shkrim.

17 Kemi ardhur në përfundim të seancës së sotme.

18 Do të doja të falënderoja palët dhe zyrën e administrimit  
19 për praninë në këtë seancë. Do të doja të falënderoja po ashtu  
20 edhe përkthyesit, stenografët, teknikët audiovizivë edhe  
21 personelin e sigurisë.

22 Ky është fundi i seancës. Faleminderit.

23 --- Seanca përfundon në orën 15.35

24